SHOQATA E PËRPUNUESVE TË DRURIT TË KOSOVËS – WOOD CLUSTER

RAPORT I PUNËS SË SHPDK-së

Periudha: Janar – Dhjetor 2025

Rr. Murat Mehmeti, nr.58
Prishtinë 10000 Republika e Kosovës
www.kosovowood.org

PËRMBAJTJA

Rreth SHPDK-së 3
Misioni 4
Hyrje.....5
Struktura organizative e SHPDK-së 6
Shërbimet e SHPDK-së 8
Projektet 12
Prezenca në media dhe rrjete sociale.....36
Rezultatet dhe të Arriturat.....38
Anëtarët e SHPDK-së 38

RRETH NESH

Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK) është themeluar në vitin 2004.
SHPDK është organizatë jofitimprurëse për kompanitë në
sektorin e përpunimit të drurit.
Roli i SHPDK-së është të mbështesë këto kompani,
dhe të avokoj në emër të tyre në nivelet legjislative dhe rregullore.
SHPDK promovon interesat e kompanive të përpunimit të drurit në Kosovë.
SHPDK mbështet këto kompani për të zgjeruar rrjetëzimin me
bizneset vendore dhe ndërkombëtare, për të përmirësuar produktet dhe cilësinë, për të përmirësuar teknologjitë, dhe për të rritur produktivitetin, me fokus përfundimtar në rritjen e eksporteve.

MISIONI

- **Promovimi i produkteve të drurit të prodhuara në Kosovë**
- **Identifikimi i klientëve dhe partnerëve të biznesit të huaj potencial**
- **Rritja e anëtarësisë dhe mbështetja e anëtarëve me pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare, misione biznesi, takime dhe ngjarje B2B**
- **Ofrimi i trajnimeve profesionale për fuqinë punëtore ekzistuese dhe të ardhme të industrisë**
- **Ofrimi i udhëzimeve për prodhuesit e Kosovës dhe të ndihmohen ata për të qenë konkurrues në tregjet ndërkombëtare dhe vendore**
- **Të ndihmohen kompanitë të ndjekin tendencat globale dhe moderne në sektorin e tyre**
- **Ofrimi i mbështetjes së nevojshme që ato të ngritin veten si marka të mirënjohura**

HYRJE

Është kënaqësi e veçantë të paraqes këtë raport te periudhes Janar – Dhjetor 2025 që pasqyron punën e zellshme dhe të përkushtuar të Shoqatës së Përpunuesve të Drurit të Kosovës – Wood Cluster lidhur me përpjekjet e saja për mbështetje të kompanive për të zgjeruar rrjetëzimin me bizneset vendore dhe ndërkombëtare, për të përmirësuar produktet dhe cilësinë, për të përmirësuar teknologjitë, dhe për të rritur produktivitetin, me fokus përfundimtar në rritjen e eksporteve.
Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës – Wood Cluster është themeluar në vitin 2004. SHPDK është organizatë jofitimprurëse për kompanitë në sektorin e përpunimit të drurit. Roli i SHPDK-së është të mbështesë këto kompani, dhe të avokoj në emër të tyre në nivelet legjislative dhe rregullatore. SHPDK promovon interesat e kompanive të përpunimit të drurit në Kosovë.
Qëllimi i SHPDK-së është që të përkrah zhvillimin modern ekonomik të industrisë së drurit në Kosovë.

Gjate kësaj periudhe ne kemi implementuar disa projekte zhvillimore të cilat kanë pasur për qëllim promovimin e produkteve të drurit të prodhuara në Kosovës, pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare, misione biznesi, takime dhe ngjarje B2B, etj.


SHPDK ka zhvilluar aktivitete të promovimit të industrisë së drurit në Kosovë, me qëllim të rritjes së tregut të produkteve të drurit të Kosovës, dhe të ndihmohen ata për të qenë konkurrues në tregjet ndërkombëtare dhe vendore.

SHPDK ka zhvilluar projekte avokuese me qëllim të nxitjes së politikave me të favorshme fiskale. Të gjitha këto kanë një qëllim stimulimin e bizneseve kosovare, të ndihmohen ato të ndjekin tendencat globale dhe moderne në sektorin e tyre.

SHPDK ka arritur të zhvillojë një rrjet të gjerë të kontakteve dhe të bashkëpunimit me ministri, asociacione të biznesit, ndërmarrës, institucione financiare, OJQ ndërkombëtare dhe vendore, me ekspert ndërkombëtare dhe vendor, me organizata qeveritare të huaja të cilat veprojnë në Kosovë dhe jashtë saj.

Për të gjitha të arriturat dhe rezultatet e kesaj periudhe falënderojmë stafin, bordin dhe anëtaret e SHPDK-së, që ishin pjesë e aktiviteteve dhe të arriturave tona.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHPDK-së



Kuvendi i SHPDK-së

Kuvendi përbëhet nga 68 anëtarët e SHPDK-së

Bordi i SHPDK-së

Zenel Kelmendi ..... Kryetar i SHPDK-së
Hashim Deshishku ..... Nënkryetar i SHPDK-së
Sheqer Ukaj ..... Anëtar i Bordit
Kreshnik Shehu .....Nënkryetar i dytë/Thesarist i SHPDK-së
Miftar Veseli ..... Anëtar i Bordit
Mentor Zekaj ..... Anëtar i Bordit
Ekrem Shahini ..... Anëtar i Bordit
Nazmi Mehmetaj ..... Anëtar i Bordit
Imri Sopaj ..... Anëtar i Bordit

Personeli

Arieta Vula ..... Drejtoreshë Ekzekutive

Naser Pozhegu ..... Projekt Menaxher dhe Financa

Liridona Kastrati ..... Koordinatore e Projekteve

Halil Kaja ..... Financier

SHËRBIMET E SHPDK-së gjate vitit 2025

1. Promovimi i produkteve të drurit të prodhuara në Kosovës.

Promovimi i produkteve të drurit të prodhuara në Kosovë është një mundësi të inkurajojë zhvillimin ekonomik lokal dhe të promovojë qëndrueshmërinë mjedisore.

SHPDK kryen sherbime promovimi për anëtaret e saj përmes kanaleve të ndryshme promovuese si:

- Promovim në web faqen e saj ***www.kosovowood.org***.
- Promovim përmes **Katalogut** të dizajnuar me rreth 70 kompani të industrisë së përpunimit të drurit.
- Promovim përmes **mediave sociale**, i cili me shume perpjekje eshte arritur me sukses, ku prezenca e kompanive përmes shoqatës ka qenë shumë aktive, dhe është arritur një audiencë e knaqshme.
- Promovim përmes **ekspozimit** në panaire nderkombetare.
- Promovim përmes misioneve **B2B**.
- Rrjetizim midis kompanive vendore dhe atyre ndërkombëtare.

2. Identifikimi i klientëve dhe partnerëve të biznesit të huaj potencial.

Identifikimi i klientëve dhe partnerëve të biznesit të huaj në industrinë e drurit është një proces i rëndësishëm për kompanitë Anëtare që operojnë në këtë sektor. Kjo eshte arritur me:

- Pjesëmarrjen e antarëve në ngjarje ndërkombëtare, panaire të ndryshme, takime B2B, vizita dhe konferenca përkatese për industrine e drurit, pjesëmarrje në grupet punuese me fokus industrinë dhe strategjinë e përpunimit të drurit.
- Bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare ose rrjetet e ndërmarrjeve të lidhura me industrinë e drurit duke marrur pjesë në ngjarje dhe takime të tyre, prej të cilës Anëtarët bëjnë kontakte të rëndësishme me klientë dhe partnerë potencialë.

3. Rritja e anëtarësisë dhe mbështetja e anëtarëve me pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare, misione biznesi, takime dhe ngjarje B2B.

SHPDK në vazhdimësi është në rritje të numrit të Anëtarësisë përmes një strategjie marketingu dhe promovimi duke prezentuar vlerën dhe avantazhet e antarësisë në Shoqatë.

SHPDK tashmë shumë vite projekton, organizon dhe menaxhon panaire të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku mund ti cekim panairet në te cilat antarët tash e disa vite kanë shprehur gatishmërinë për ekspozim të produkteve të tyre:

- Imm Cologne në Gjermani.
- Swiss Bau në Basel/Zvicër,
- Stockholm Furniture Fair në Suedi

- Konventa e Industrisë së Drurit të Kosovës

SHPDK-ja bën organizimin e konferencave, seminareve dhe workshope, pjesëmarrje në vizita dhe konferenca jashtë vendit me interes për kompanitë anëtare. Ndër organizimet më të rëndesishme mund ti cekim:

- Takimet B2B/ rrjetëzime gjatë Konventës se Industrisë së Drurit te Kosoves .
- Takimet B2B gjatë Swiss Bau Zvicër mes kompanive të industrisë së drurit të Kosovës me kompani kryesisht të diaspores në Zvicër.
- Takimet B2B gjatë panairit Imm Cologne në Gjermani mes kompanive të industrisë së drurit të Kosovës me kompani kryesisht të diaspores në Gjermani.

4. Ofrimi i trajnimeve profesionale për fuqinë punëtore ekzistuese dhe të ardhme të industrisë.

SHPDK-ja organizon trajnime të ndryshme profesionale për fuqinë punëtore ekzistuese dhe të ardhme të industrisë si:

- Instruktor në Vendin e Punës.
- Soft Skills Training.
- Trajnime Profesionale në Industrinë e përpunimit të drurit.
- Trajnime, praktikë pune dhe punësim i të papunëve në industrinë e drurit.

5. Ofrimi i udhëzimeve për prodhuesit e Kosovës dhe të ndihmohen ata për të qenë konkurrues në tregjet ndërkombëtare dhe vendore.

SHPDK-ja ofron informata me interes për sektorin për anëtarët, informata për industrinë e drurit dhe statistikat për treg, informata për eksportin e prodhimeve vendore etj, shpallje dhe grante të ndryshme, mundësi biznesi, mundësi certifikimi të produkteve etj.

SHPDK ofron trajnime dhe udhëzime për kompanitë antare që dëshirojnë të marrin pjesë në misione ndërkombëtare (ekspozime, b2b, rrjetëzime, pjesemarrje në konferenca).

6. Të ndihmohen kompanitë të ndjekin tendencat globale dhe moderne në sektorin e tyre

Pjesëmarrja në vizita panaire dhe konferenca është një mënyrë e shkëlqyer për të ndihmuar industrinë të ndjekë trendin. Këto ngjarje ofrojnë një platformë të shkëlqyer për kompanitë për të eksploruar inovacionet, të ndajnë idetë, dhe të bëjnë lidhje me aktorë të tjerë në fushën e tyre. Këtu janë disa mënyra se si pjesëmarrja në këto ngjarje ndihmon industrinë të ndjekë trendet:

Eksplorimi i teknologjive të reja: Konferencat dhe panairet janë vendet ku shpesh paraqiten teknologji të reja dhe inovative. Duke marrë pjesë, përfaqësuesit nga kompanitë mund të mësojnë për teknologjitë e fundit dhe të shikojnë se si ato mund të përdoren në industrinë e tyre.

Ngritja e ndërgjegjësimit për trendet aktuale: Duke dëgjuar prezentime nga ekspertë të fushës, ata mund të informoheni mbi trendet aktuale dhe sfidat që përballon industria.

Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi: Konferencat dhe panairet ofrojnë mundësinë për të bërë lidhje me profesionistë të tjerë, klientë potencialë, dhe partnerë të mundshëm.

Përmirësimi i aftësive dhe dijes: Konferencat shpesh ofrojnë seminare dhe workshope të specializuara që mund të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive dhe njohurive.

7. Ofrimi i mbështetjes së nevojshme që ato të ngritin veten si marka të mirënjohura

Pjesëmarrja aktive në evente ndërkombëtare është një mjet i rëndësishëm për të ngritur profilin e sektorit të drurit dhe për të tërhequr investime të reja në këtë industri. Disa nga mënyrat se si kjo pjesëmarrje kontribuon në arritjen e këtyre qëllimeve janë:

Njohja e Industrisë: Pjesëmarrja në evente ndërkombëtare ja mundëson Shoqatës të prezantojë potencialin dhe fuqinë e sektorit të drurit në nivel global. Kjo njohje mund të rrisë ndërgjegjësimin ndër investitorët e huaj për mundësitë që ofron kjo industri.

Prezantimi i ofertave: Eventet ndërkombëtare ofrojnë një platformë të përshtatshme për të prezantuar produktet dhe shërbimet e industrisë së drurit. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të treguar cilësinë, inovacionet dhe konkurrencën e sektorit.

Krijimi i lidhjeve: Pjesëmarrja në këto evente mund të sjellë kompanitë në kontakt me investitorët e huaj, bizneset ndërkombëtare dhe partnerë potencialë. Ky rrjetëzim dhe bashkëpunim mund të sjellë investime të reja dhe marrëveshje biznesi.

Nxitja e Investimeve të huaja: Duke prezentuar sektorin e drurit në mënyrë tërheqëse dhe duke ofruar informacion të rëndësishëm për klimën e investimeve në vend, Shoqata mund të nxisë investitorët e huaj të shqyrtojnë mundësitë për të investuar në industrinë e drurit.

8. Avokim dhe Lobim

SHPDK-ja bën avokim dhe lobim për mbrojtjen e interesave të bizneseve në industrinë e drurit të Kosovës duke marr pjesë takime të rëndësishme dhe të rregullta, anetare në këshille dhe grupe punuese tek institucionet, donatorët egzistues dhe të rinjë, ministritë në departamentet perkatese:

- Udheheqëse e Këshillit Sektorial për zhvillim të fuqisë punëtore në sektorin e përpunimit të drurit, mbështetur nga IREX- USAID
- Udheheqëse e strategjisë për industrinë e drurit në punëtoritë për Strategjinë e Specializimit të Mençur, udhëhequr nga Zyra për Planifikim Strategjik në kuader të ZKM.
- Antare e Keshillit në Task Forcën për Arsimin Dual, udhëhequr nga MASHTI.
- Antare në forumin për zhviliimin e politikave industriale të organizuara nga MINT për interesa të industrise së drurit.
- Antare e këshillit në Agjencinë e pyjeve të Kosovës udhëhequr nga Ministria e Bujqësise, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural.
- Pjesëmarrje e rregullt dhe angazhim në Grow Agency, mbështetur nga ZKM të Kosovës.

9. Ndërmjetsime – Fasilitime

SHPDK-ja bën rolin e ndërmjetësuesit për Kompanitë Anëtare duke i ofruar fuqi punëtore përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës. Kjo ndihmon kompanitë të gjejnë dhe të sigurojnë punonjës të kualifikuar dhe të përshtatshëm për nevojat e tyre të punësimit, ndërsa gjithashtu ofron mundësi punësimi për qytetarët e Kosovës. Ky bashkëpunim midis SHPDK-së dhe Agjencisë së Punësimit është në dobi të të dyja palëve, duke ndihmuar në rritjen e mundësive për zvogëlimin e papunësisë dhe në përmirësimin e zhvillimit ekonomik të vendit.

PROJEKTET E REALIZUARA NGA SHPDK

Projektet e realizuara nga SHPDK përgjatë vitit 2025 dhe të mbeshtetura sipas donatoreve në vijim: (këtu perfshihen edhe disa projekte që kanë filluar në vitin 2024 dhe kanë perfunduar në vitin 2025):

1. Qeverisja dhe Organet e SHPDK-së (2025)

2. Aplikimet e SHPDK-së në Projekte dhe Ekspozita Ndërkombëtare

3. SHPDK - Projekti: Private Sector-Led Workforce Development
   Mbështetur nga: IREX-USAID
   Periudha: Janar 2023 – Janar 2025

4. SHPDK - Projekti: Sektori i Mobiljeve - Fasilitimi i Rritjes dhe Lidhjeve 2
   Mbështetur nga: Swisscontact FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA)
   Periudha: Nëntor 2024 – Mars 2025

5. SHPDK: Takime B2B në Gjermani – Düsseldorf dhe Organizimi i Vizitës në Panairin LIGNA, Gjermani
   Mbështetur nga: Swisscontact FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA)
   Periudha: (23–24 Maj 2025)

6. Mision Ndërkombëtar dhe Integrimi i SHPDK-së në Rrjete Evropiane të Industrisë së Mobiljeve *(Meta Furniture Cluster, Suedi – Konferenca dhe Vizita Studimore)*
   Mbështetur nga: Swisscontact FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA)
   Periudha: Janar – Dhjetor 2025

7. Vizitë studimore në Hungari dhe Portugali për Këshillat Sektoriale të Shkathtësive dhe Sistemet e Qeverisjes së Shkathtësive
   Mbështetur nga: Projekti “Matching Skills to Jobs (MSJ)”
   Periudha Tetor – Nëntor 2025

8. Riakreditimi SHPDK-së për Programin e Trajnimit Instruktor në Vendin e Punës
   Periudha: Janar 2024 – Dhjetor 2025

9. Zhvillimi dhe Aprovimi i Standardeve Profesionale për Industrinë e Drurit

Periudha: Janar – Dhjetor 2025

10. SHPDK – Projekti: Empowering Kosovo's Wood Industry through Dual Vocational Education and Training Innovation
    Mbështetur nga: Luxembourg Development Cooperation Agency
    Periudha: Tetor 2025 – Shtator 2026

11. SHPDK – Organizimi i Konventës së Industrisë së Drurit – Edicioni 8
    Mbështetur nga: LuxDev – projekti "Shkathtësitë për punësim të qëndrueshëm në Kosovë", Swisscontact - projekti FEGO i financuar nga Qeveria e Suedisë, ProCredit Bank, si dhe projekti "Matching Skills to Job" (MSJ), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe implementuar nga Swisscontact.
    Periudha: Tetor – Nëntor 2025

1. Qeverisja dhe Organet e SHPDK-së (2025)

1.1 Mbledhja e Kuvendit të SHPDK-së

Pjesëmarrja: 44 anëtarë me të drejtë vote nga gjithsej 64 (korum i plotësuar)
Qëllimi i Kuvendit: Mbledhja e Kuvendit u mbajt me qëllim shqyrtimin dhe miratimin e raporteve vjetore të punës dhe financiare, aprovimin e planeve për vitin 2025, harmonizimin e Statutit të SHPDK-së me legjislacionin në fuqi, si dhe zhvillimin e procedurave zgjedhore për organet drejtuese të shoqatës.
Vendimet kryesore të Kuvendit:

- U konstatua kuorumi dhe u aprovua rendi i ditës me vota unanime.
- U miratua Raporti i Punës i SHPDK-së për vitin 2024.
- U miratua Raporti i Financave të Audituara për vitin 2024.
- U aprovuan planet dhe objektivat strategjike për vitin 2025.
- U miratua ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të SHPDK-së, në përputhje me Ligjin për OJQ-të.
- U aprovua ndryshimi i emrit të organizatës në: Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës – Wood Cluster (SHPDK).
- Procesi zgjedhor për Kryetarin e Kuvendit dhe organet e tjera u ndërpre dhe u la për trajtim të mëtejmë, sipas procedurave statutore.

Kuvendi shërbeu si platformë për rikonfirmimin e transparencës, llogaridhënies dhe rolit të Kuvendit si organi më i lartë vendimmarrës i SHPDK-së.

1.2 Mbledhjet e Bordit të SHPDK-së (2025)

Gjatë vitit 2025, Bordi i SHPDK-së ka mbajtur tre (3) mbledhje zyrtare, në përputhje me statutin dhe rregulloret e brendshme të shoqatës.
Fokusi i mbledhjeve të Bordit:

- Udhëzimi strategjik për aktivitetet e SHPDK-së gjatë vitit.
- Shqyrtimi i aktiviteteve programore dhe projekteve në zhvillim.
- Koordinimi me Drejtoreshën Ekzekutive për çështje organizative dhe përfaqësuese.
- Trajtimi i çështjeve që lidhen me funksionimin e brendshëm dhe përfaqësimin e interesave të anëtarëve.

Bordi ka luajtur rol këshillues dhe mbikëqyrës, duke kontribuar në orientimin strategjik të shoqatës gjatë vitit raportues**.**

1.3 Grupi Punues për Konventën e Industrisë së Drurit

Përbërja e grupit punues:
Arieta Pozhegu, Miftar Veseli, Sheqer Ukaj, Kreshnik Shehu, Behlul Shaljani (LuxDev) dhe Argjenta Plakolli (FEGO).
Periudha e angazhimit: Tetor – Nëntor 2025

Qëllimi: Gjatë muajve tetor dhe nëntor 2025, u krijua një grup punues i dedikuar për organizimin dhe finalizimin e Konventës së Industrisë së Drurit. Grupi ka zhvilluar takime të rregullta javore, me fokus në planifikimin, koordinimin dhe përgatitjen e përmbajtjes programore dhe logjistike të Konventës.

Rezultatet kryesore:

- Koordinim efektiv ndërmjet stafit dhe anëtarëve kontribuues.
- Finalizimi i strukturës dhe konceptit të Konventës.
- Sigurimi i një procesi të organizuar dhe gjithëpërfshirës për një nga aktivitetet kryesore të SHPDK-së.

Ky angazhim i përbashkët ka kontribuar drejtpërdrejt në suksesin dhe profesionalizmin e Konventës, duke reflektuar modelin e bashkëpunimit ndërmjet mbështetësve, stafit dhe anëtarëve të SHPDK-së.

Përfundim: Gjatë vitit 2025, Kuvendi, Bordi dhe grupet punuese të SHPDK-së kanë ushtruar funksionet e tyre në përputhje me statutin dhe parimet e qeverisjes së mirë, duke siguruar vendimmarrje, mbikëqyrje dhe koordinim për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqatës dhe sektorit të përpunimit të drurit në Kosovë.

2. Aplikimet e SHPDK-së në Projekte dhe Ekspozita Ndërkombëtare

Gjatë vitit 2025, SHPDK ka qenë aktive në hartimin dhe aplikimin e projekteve strategjike, me fokus në ndërkombëtarizimin e sektorit të drurit, zhvillimin e kapaciteteve të bizneseve dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerë dhe donatorë ndërkombëtarë.

Projektet dhe aplikimet e miratuara:

- Stockholm Furniture Fair – aplikimi i SHPDK-së për pjesëmarrjen e kompanive kosovare në këtë panair ndërkombëtar është miratuar, duke krijuar mundësi të rëndësishme për ekspozim dhe rrjetëzim në tregun nordik.

- Swissbau 2026 (Basel, Zvicër) – projekti për pjesëmarrjen e kompanive kosovare në panairin Swissbau 2026 është miratuar nga KIESA. Në kuadër të këtij projekti, janë përzgjedhur 26 kompani ekspozuese, ndërsa projekti ndodhet në fazën finale të zbatimit. Ekspozimi do të mbahet më 20–24 janar 2026, me pjesëmarrjen aktive të firmave kosovare nga industria e drurit dhe mobilieve.

- Projekti për Mësimin Profesional Dual (LuxDev) – aplikimi i SHPDK-së për zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të Mësimit Profesional Dual, në partneritet me LuxDev, është miratuar, duke synuar përfshirjen e bizneseve në formimin praktik të fuqisë punëtore dhe përmirësimin e lidhjes ndërmjet arsimit profesional dhe tregut të punës.

- Projekti: Takime B2B në Gjermani – projekt-propozim i përgatitur nga SHPDK me qëllim organizimin e misioneve tregtare dhe takimeve B2B për kompanitë kosovare të sektorit të drurit dhe mobiljeve në tregun gjerman, forcimin e bashkëpunimit me diasporën dhe krijimin e partneriteteve afatgjata

eksportuese. Mbështetje financiare e siguruar përmes Projektit FEGO – "Nxitja e Mundësive të Punësimit dhe Rritjes", i implementuar nga Swisscontact dhe i financuar nga Qeveria Suedeze.

- Konventa e Industrisë së Drurit – projekti për organizimin e Konventës ka siguruar mbështetjen e partnerëve dhe donatorëve: LuxDev – projekti "Shkathtësitë për punësim të qëndrueshëm në Kosovë", Swisscontact - projekti FEGO i financuar nga Qeveria e Suedisë, ProCredit Bank, si dhe projekti "Matching Skills to Job" (MSJ), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe implementuar nga Swisscontact, duke garantuar realizimin e këtij aktiviteti si një platformë kyçe për dialog, promovim dhe bashkëpunim ndërmjet sektorit privat, institucioneve dhe partnerëve zhvillimorë.

Këto rezultate dëshmojnë rolin aktiv të SHPDK-së në përfaqësimin e interesave të anëtarëve të saj, në sigurimin e mbështetjes institucionale dhe donatore, si dhe në promovimin e industrisë së drurit të Kosovës në tregjet ndërkombëtare.

3. SHPDK - Projekti: Private Sector-Led Workforce Development
Mbështetur nga: IREX-USAID
Periudha: Janar 2023 – Janar 2025

Qëllimi

Qëllimi i projektit ishte formimi i Këshilli i Fuqisë Punëtore të Sektorit të Përpunimit të Druriti cili është krijuar me qëllim të bashkimit të sektorit privat, ofruesve të trajnimit dhe zhvillimit të fuqisë punëtore, institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor, shoqërisë civile, diasporës dhe organizatave donatore për të përcaktuar nevojat e zhvillimit të fuqisë punëtore dhe mbështetjen e zgjidhjeve të zhvillimit të fuqisë punëtore për qëllime të arsimit dhe aftësimit profesional (AAP). Më 24 janar 2025, SHPDK pranoi njoftim zyrtar nga IREX për **pezullimin e plotë të nën-grantit FY23-PSWD-AWPK-01**, me efekt të menjëhershëm, si pasojë e urdhrit për ndalim të punës (*stop work order*) të lëshuar nga USAID. Ky vendim lidhej me procesin e **rishqyrtimit dhe rialinjimit të ndihmës së jashtme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës** (*"Reevaluating and Realigning United States Foreign Aid"*), të shpallur nga Shtëpia e Bardhë më 20 janar 2025. Si rrjedhojë, të gjitha aktivitetet e projektit u ndalën, shpenzimet u pezulluan dhe materialet dhe të dhënat e projektit u siguruan në përputhje me kërkesat e donatorit.

Aktiviteti dhe Pjesëmarrja

- Nënshkrimi i Marrëveshjes 3 vjeqare në mes të SHPDK dhe PSWD
- Publikimi i rregullt i të dhënave të nxjerra nga hulumtimet në kanalet e mediave sociale të SHPDK-së
- Takime të rregullta me Keshillin e Fuqisë Punëtore të Sektorit të Përpunimit të Drurit

- Pjesemarrje e përbashket me IREX dhe 3 Këshillet e formuara: IREX - SHPDK – STIKK – AGRO
- Takime të rregullta me mentorin e përzgjedhur të diasporës 'Peer-to-Peer Diaspora Mentorship Acivity'
- Pjesëmarrje në takimin me Presidenten e IREX dhe Drejtoreshen Rajonale për qëndrueshmërinë e këshillit.
- Pjesëmarrje në Ngjarjen e Germin & PSWD: Shfrytëzimi i burimeve të diasporës për të fuqizuar Këshillat e Fuqisë Punëtore dhe krijimi i zgjidhjeve inovative për Fuqinë Punëtore me mbështetje nga Diaspora.
- Pjesëmarrje në punëtoritë për zhvillim të standardeve të profesionit për Industrinë e Drurit.
- Publikim i shpalljes vjetore për Grante në Industrinë e Drurit
- Informim i kompanive Antare për shpalljen e grantit direkt përmes emailit dhe kanaleve tjera informative, dhe inkurjamimi për të aplikuar.

Rezultate

- Aprovimi i dokumenteve: Rregulloren e punës së Këshillit (verzioni i rishikuar),
- Rregulloren e procedurës e komisionit të granteve,
- Planin e ngritjes të kapacitetit të Këshillave,
- Planin e punës të Këshillave dhe
- Planin e veprimit të politikave.
- Zhvillimi i darfteve finale të standardeve të profesionit për Zdrukthtar dhe Mobileri


USAID
IREX
Private Sector-Led
Workforce
Development
Activity

4. **SHPDK - Projekti: Sektori i Mobiljeve - Fasilitimi i Rritjes dhe Lidhjeve 2**
   Mbështetur nga: Swisscontact FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA)
   Periudha: Nëntor 2024 – Mars 2025





Qëllimi

Ky projekt ka për qëllim forcimin e industrisë së mobiljeve në Kosovë duke krijuar lidhje tregtare me Suedinë. Kosova ka shënuar rritje të qëndrueshme në këtë industri, por ka sfida në hapjen e tregjeve më të gjera përtej diasporës. Projekti FEGO, i financuar nga SIDA, synon të forcojë bashkëpunimin midis dy vendeve, duke mundësuar mundësi eksporti dhe shkëmbim njohurish përmes organizimit të aktiviteteve si Panairi i Mobiljeve në Stokholm dhe Misioni B2B. Ky bashkëpunim do të ndihmojë bizneset e vogla dhe të mesme kosovare të rrisin mundësitë e eksportit dhe të krijojnë mundësi investimi.

Aktiviteti dhe Pjesëmarrja

- Projekti FEGO dhe SHPDK ka realizuar një vizitë para-misioni nga Interior Cluster Sweden në Kosovë, duke përfshirë hulumtime të tregut dhe koordinimin me palët e interesuara.
- Pjesëmarrësit nga Interior Cluster Sweden, si Susanne-Kikki Israelsson dhe Erik Lundh, vizituan fabrika të mobiljeve për të parë nga afër qasjet inovative të prodhuesve lokalë.
- Aktivitetet e tilla janë të rëndësishme për SHPDK-në, e cila luan një rol kyç në organizimin dhe ekzekutimin e Misionit B2B, duke ofruar mbështetje për anëtarët e saj në hulumtime tregu dhe lidhje ndërkombëtare. Ky bashkëpunim mund të shërbejë si model për nisma të tjera të ngjashme në të ardhmen.
- Në kuadër të vizitave të 11 kompanive kosovare, janë shënuar zhvillime pozitive, përfshirë interesin e blerësve suedezë për produktet e kompanive si Elnor, Berto, Terrastone dhe Group-Ks.
- Ky bashkëpunim mund të sjellë mundësi afatgjata për rritjen e eksportit dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës në sektorin e mobiljeve në Kosovë.
- Si vazhdimësi e drejtpërdrejtë e këtij procesi dhe bazuar në rezultatet pozitive të fazës përgatitore dhe misioneve B2B, industria e mobiljeve të Kosovës u prezantua në **Stockholm Furniture Fair**

2025 (04–08 shkurt 2025), një nga panairet më të rëndësishme ndërkombëtare për dizajnin e mobilieve dhe ndriçimit. Ky panair shërbeu si platformë kyçe për promovimin e dizajnit të qëndrueshëm dhe inovativ dhe për zgjerimin e bashkëpunimeve tregtare në tregun skandinav.

- Në panair, **7 kompani kosovare** (Elnor Furniture, Tedes Contract Furniture, Tefik Canga, Cassi, Divani, Pro Home Design dhe Fitore Syla) prezantuan për herë të dytë industrinë e mobiljeve të Kosovës në tregun skandinav, duke ekspozuar produkte me cilësi të lartë dhe dizajn bashkëkohor, përfshirë karrige, tavolina, sofa, dollapë, mobilie për kopsht, ndriçim dhe produkte të tjera prej druri. Organizimi dhe koordinimi i pjesëmarrjes u realizua nga SHPDK me mbështetjen e Swisscontact – Projekti FEGO.
- Përzgjedhja e kompanive u realizua në mënyrë transparente, përmes shpërndarjes së informacionit te të gjithë anëtarët e SHPDK-së; të gjitha kompanitë që shprehën interesim për ekspozim u pranuan dhe u bënë pjesë e projektit të SHPDK-së.

Rezultatet

- Gjatë ekspozimit, kompanitë nga Kosova ishin shumë të përgatitura dhe paraqitën në mënyrë profesionale produktet e tyre.
- Dizajnet e produkteve dhe cilësia e tyre ishin në përputhje me trendet e tregut aktual, ndërsa çmimet ishin konkurruese.
- Sa i përket menaxhimit profesional të porosive, përfshirë aspekte si koha e dorëzimit, kushtet e pagesës dhe ruajtja e cilësisë së qëndrueshme të produkteve, kompanitë treguan informacion të plotë dhe përgatitje për të ardhmen.
- Pjesëmarrja e industrisë së mobiljeve të Kosovës në ***Stockholm Furniture Fair 2025*** solli rezultate të rëndësishme dhe ndikim të drejtpërdrejtë për kompanitë kosovare. Pavijoni i Kosovës u vizitua nga përfaqësues të *Interior Cluster Sweden*, blerës nga rrjete ndërkombëtare si IKEA dhe RUSTA, si dhe nga aktorë kyç të tregut, duke krijuar kontakte të reja dhe mundësi bashkëpunimi.
- Kompanitë kosovare realizuan vizita studimore në kompani inovative dhe showroom-e në Stokholm, duke njohur trendet më të fundit të industrisë dhe duke shkëmbyer përvoja me profesionistë ndërkombëtarë.
- Gjatë panairit, kompanitë prezantuan produktet e tyre me profesionalizëm, duke nxjerrë në pah dizajnin inovativ, cilësinë e lartë dhe aftësinë për menaxhimin e porosive dhe operacioneve në tregje ndërkombëtare. Vizitorët u tërheqën nga stendat e dizajnuara me kujdes dhe produktet inovative, duke krijuar kontakte të rëndësishme dhe perspektiva për porosi të ardhshme dhe bashkëpunime afatgjata.
- Marketingu dhe prezantimi i kompanive u realizua me materiale profesionale si katalogë dhe broshura në gjuhën angleze, duke rritur dukshmërinë dhe pozicionimin e produkteve kosovare në tregun ndërkombëtar.
- SHPDK, së bashku me stafin dhe ekspertët nga Suedia, ofroi takime B2B dhe B2C për të gjithë ekspozuesit-anëtarët e saj gjatë ditëve të plota të panairit
- Eksporti i realizuar në tremujorin e parë pas ekspozimit të kompanive rezultoi të jetë mbi 430,000 € (sipas matjeve dhe monitorimit nga SHPDK). Për herë të parë, kompanitë u hapën në këtë treg skandinav, dhe pritshmëritë për rritje janë pozitive.

SHPDK
Association of Wood Processors of Kosovo - Wood Cluster





supported by:
FE
GO

5. **SHPDK: Takime B2B në Gjermani – Düsseldorf dhe Organizimi i Vizitës në Panairin LIGNA, Gjermani**
   Mbështetur nga: Projekti FEGO – "Nxitja e Mundësive të Punësimit dhe Rritjes", i implementuar nga Swisscontact dhe i financuar nga Qeveria Suedeze
   Periudha: (23–24 Maj 2025)

Qëllimi

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte:

- Të mbështesë ndërkombëtarizimin e kompanive kosovare të sektorit të drurit dhe mobiljeve;
- Të krijojë lidhje direkte B2B me kompani gjermane dhe të diasporës shqiptare në Gjermani;
- Të forcojë bashkëpunimin me diasporën si urë lidhëse për eksport;
- Të ofrojë qasjen e kompanive kosovare në panaire strategjike, përfshirë vizitën profesionale në panairin ndërkombëtar LIGNA – panairi më i madh në botë për industrinë e drurit dhe teknologjitë e përpunimit.

Aktiviteti dhe Pjesëmarrja

Takimet B2B u mbajtën më 23–24 Maj 2025 në Düsseldorf, Gjermani, dhe u organizuan nga SHPDK, me mbështetje financiare nga Projekti FEGO – "Nxitja e Mundësive të Punësimit dhe Rritjes", i implementuar nga Swisscontact dhe i financuar nga Qeveria Suedeze, në bashkëpunim me Unionin e Bizneseve Kosovë–Gjermani (UB).
Aktiviteti përfshiu:

- Organizimin e takimeve të strukturuara B2B mes kompanive kosovare dhe atyre gjermane/diasporës;
- Vizita zyrtare studimore në kompani të suksesshme në Gjermani;
- Koordinimin dhe mbështetjen e delegacionit kosovar gjatë gjithë qëndrimit;
- Organizimin dhe lehtësimin e vizitës profesionale në panairin LIGNA, me fokus në teknologji të avancuara, inovacion dhe trende të reja në industrinë e drurit.

Në aktivitet morën pjesë 13 kompani nga Kosova, anëtare të SHPDK-së, si dhe rreth 15 kompani nga diaspora dhe tregu gjerman.

Rezultatet e Arritura

- Krijimi i kontakteve direkte mes kompanive kosovare dhe atyre gjermane/diasporës.
- Promovimi i produkteve dhe kapaciteteve të industrisë së përpunimit të drurit nga Kosova.
- Rritja e potencialit për marrëveshje të reja eksporti dhe bashkëpunimi afatgjatë.
- Ndikim i drejtpërdrejtë në rritjen e të ardhurave për kompanitë dhe krijimin e vendeve të reja të punës në sektorin e drurit në Kosovë.
- Përforcimi i rolit të diasporës në zhvillimin ekonomik dhe rrjetëzimin ndërkombëtar të ndërmarrjeve kosovare.

6. **Mision Ndërkombëtar dhe Integrimi i SHPDK-së në Rrjete Evropiane të Industrisë së Mobiljeve *(Meta Furniture Cluster, Suedi – Konferenca dhe Vizita Studimore)***
   Mbështetur nga: Projekti FEGO – "Nxitja e Mundësive të Punësimit dhe Rritjes", i implementuar nga Swisscontact dhe i financuar nga Qeveria Suedeze
   Periudha: Janar – Dhjetor 2025

Qëllimi

Qëllimi i këtij misioni ndërkombëtar ishte forcimi i rolit përfaqësues dhe institucional të SHPDK-së në rrjete dhe organizata evropiane të sektorit të drurit dhe mobiljeve, përmes anëtarësimit aktiv, pjesëmarrjes në struktura vendimmarrëse, shkëmbimit të përvojave dhe ndërtimit të partneriteteve strategjike. Ky angazhim synon rritjen e konkurrueshmërisë, ndërkombëtarizimin dhe integrimin gradual të kompanive anëtare të SHPDK-së në zinxhirët evropianë të vlerës.

Aktiviteti dhe pjesëmarrja

Në **korrik 2025**, gjatë **Asamblesë së Tretë të Përgjithshme të GO FURNITURE**, **Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK)** u pranua zyrtarisht si **anëtare e re e Meta Furniture Cluster**, duke shënuar një moment të rëndësishëm në procesin e integrimit ndërkombëtar të sektorit kosovar të drurit dhe mobiljeve. Në kuadër të këtij misioni, SHPDK mori pjesë në **Kuvendin e Meta Furniture Cluster**, një platformë evropiane që bashkon klasterë, kompani dhe institucione nga industria e mobiljeve, dizajnit dhe përpunimit të drurit. Përfaqësuesit e SHPDK-së realizuan gjithashtu **vizita zyrtare dhe studimore në Suedi**, ku morën pjesë në konferenca tematike, takime me klasterë homologë, ekspertë të industrisë dhe aktorë të ekosistemit të inovacionit, dizajnit dhe prodhimit të avancuar.
Gjatë këtyre aktiviteteve u trajtuan modele të suksesshme të bashkëpunimit **klaster–biznes–institucione**, qasja në tregje ndërkombëtare, inovacioni në dizajn dhe prodhim, si dhe roli i klasterëve në zhvillimin e zinxhirëve të vlerës dhe politikave sektoriale në industrinë e mobiljeve.

Rezultati

Si rezultat i këtij misioni ndërkombëtar, SHPDK:

- Ka forcuar pozitën e saj si përfaqësuese e sektorit të drurit dhe mobiljeve të Kosovës në rrjete dhe platforma evropiane;
- Ka zgjeruar rrjetin e kontakteve strategjike me klasterë, organizata dhe partnerë ndërkombëtarë;
- Ka identifikuar mundësi konkrete për zhvillimin e projekteve të përbashkëta, shkëmbimin e ekspertizës dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe të kompanive anëtare;
- Ka hapur perspektiva të reja për përfshirjen e kompanive kosovare në iniciativa ndërkombëtare, panaire, misione tregtare dhe programe evropiane mbështetëse.

Ky mision përfaqëson një hap të rëndësishëm strategjik drejt integrimit të qëndrueshëm të sektorit kosovar të mobiljeve në rrjetet evropiane të industrisë, duke rritur vizibilitetin, besueshmërinë dhe potencialin eksportues të kompanive anëtare të SHPDK-së.

7. Vizitë studimore në Hungari dhe Portugali për Këshillat Sektoriale të Shkathtësive dhe Sistemet e Qeverisjes së Shkathtësive
Mbështetur nga: Projekti "Matching Skills to Jobs (MSJ)"
Periudha Tetor – Nëntor 2025



Qëllimi

Qëllimi i vizitës studimore në Hungari dhe Portugali ishte të ofrojë përfaqësuesve nga institucionet, shoqatat sektoriale dhe sektori privat në Kosovë mundësinë për të mësuar nga praktikat ndërkombëtare të funksionimit të Këshillave Sektoriale të Shkathtësive (SSC). Vizita synoi të prezantojë modele të ndryshme të qeverisjes së arsimit dhe aftësimit profesional (AAP/VET), duke analizuar mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat. Gjithashtu, aktiviteti kishte për qëllim të kontribuojë në Studimin e Fizibilitetit për themelimin e SSC-ve në Kosovë dhe të identifikojë elemente që mund të përshtaten në kontekstin vendor për përmirësimin e lidhjes ndërmjet tregut të punës dhe sistemit arsimor.

Aktiviteti dhe Pjesëmarrja

Në kuadër të projektit “Matching Skills to Jobs (MSJ)”, u organizua një vizitë studimore në Hungari dhe Portugali gjatë periudhës 27 Tetor – 1 Nëntor 2025. Delegacioni përbëhej nga përfaqësues të institucioneve publike, odave ekonomike, shoqatave sektoriale dhe sektorit privat, përfshirë SHPDK-në, AKK-në, APRK-në, STIKK-un dhe kompani private. Gjatë vizitës u zhvilluan takime me institucione kyçe si Dhoma Ekonomike e Hungarisë, Zyra Kombëtare për Arsimin Profesional, ANQEP në Portugali dhe organizata të tjera relevante për qeverisjen e aftësive dhe kualifikimeve profesionale.

Rezultatet

Vizita studimore ofroi njohuri praktike mbi modelet e funksionimit të Këshillave Sektoriale të Shkathtësive dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve publike. Pjesëmarrësit identifikuan elemente kyçe për Kosovën, si nevoja për bazë ligjore të qartë, sekretariat profesional koordinues dhe përfshirje aktive të bizneseve në zhvillimin e aftësive profesionale. Përvojat nga Hungaria dhe Portugalia kontribuan drejtpërdrejt në Studimin e Fizibilitetit për SSC-të në Kosovë dhe ndihmuan në identifikimin e modeleve të përshtatshme për zhvillimin e sistemit të arsimit profesional dhe lidhjen më të mirë të tij me tregun e punës.

8. Riakreditimi SHPDK-së për Programin e Trajnimit Instruktor në Vendin e Punës Periudha: Janar 2024 – Dhjetor 2025

Qëllimi

Qëllimi i procesit të riakreditimit ishte sigurimi i vazhdimësisë së rolit të SHPDK-së si organizatë e akredituar për ofrimin e trajnimeve dhe mësimit profesional në vendin e punës (WBT), në përputhje me standardet ligjore dhe cilësore të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve dhe institucioneve përkatëse. Ky proces synoi garantimin e cilësisë së instruktimit, forcimin e kapaciteteve profesionale dhe mbështetjen e zbatimit të Mësimit Profesional Dual në bashkëpunim me bizneset anëtare**.**

Procedurat dhe aktivitetet e ndërmarra

Gjatë procesit të riakreditimit, SHPDK ka ndërmarrë këto veprime kryesore:

- Përgatitjen dhe dorëzimin e dokumentacionit të plotë për riakreditim, në përputhje me kërkesat institucionale;
- Hartimin dhe përditësimin e materialeve trajnuese dhe metodologjike për instruktorët në vendin e punës;
- Evidentimin e përvojës praktike dhe kompetencave profesionale të instruktorëve të SHPDK-së;
- Bashkëpunimin me komisionin për vlerësim, përfshirë vizitat, intervistat dhe shqyrtimin e dokumentacionit mbështetës.

Procesi i vlerësimit është realizuar nga një komision profesional i autorizuar, i cili ka analizuar kapacitetet organizative, përmbajtjen e programeve, metodologjinë e trajnimit dhe përputhshmërinë me standardet kombëtare, i përbërë nga:

1. Xhemajl Mehmeti – Ekspert, Kryesues i Panelit Vlerësues
2. Mimoza Shahini – Eksperte, Anëtare e Panelit Vlerësues
3. Kushtrim Cukaj – Ekspert i Cilësisë, Anëtar i Panelit Vlerësues
4. Donjeta Nimani Bince – Koordinatore e Procesit nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)

Rezultati

Si rezultat i këtij procesi:

- Kërkesa e SHPDK-së është pranuar për riakreditim për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh;
- Është konfirmuar përmbushja e plotë e kritereve profesionale dhe institucionale për ofrimin e trajnimeve në vendin e punës;
- Është forcuar roli i SHPDK-së si partner kyç në zbatimin e Mësimit Profesional Dual dhe zhvillimin e fuqisë punëtore të kualifikuar për sektorin e drurit dhe mobiljeve në Kosovë.

Ky riakreditim përbën një element të rëndësishëm të qëndrueshmërisë institucionale të SHPDK-së dhe një bazë solide për zgjerimin e aktiviteteve të saj në fushën e arsimit profesional, në bashkëpunim me bizneset, institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë.



9. Zhvillimi dhe Aprovimi i Standardeve Profesionale për Industrinë e Drurit
Periudha: Janar – Dhjetor 2025

Qëllimi

Me mbështetjen e projektit PSWD, SHPDK ka udhëhequr procesin e zhvillimit dhe rishikimit të dy standardeve profesionale kyçe për industrinë e drurit:

- Standardi Profesional për Zdrukthtari
- Standardi Profesional për Mobileri

Qëllimi kryesor i këtij procesi ishte:

- përmirësimi i përputhshmërisë së standardeve profesionale me nevojat reale të tregut të punës;
- harmonizimi i aftësive dhe kualifikimeve të fuqisë punëtore në sektorin e drurit dhe mobiljeve;
- krijimi i një baze të qëndrueshme për zhvillimin e programeve të trajnimit, certifikimit dhe riakreditimit;
- forcimi i rolit të SHPDK-së si aktor referues në zhvillimin e standardeve profesionale sektoriale.

Procesi i zhvillimit dhe aplikimit

- Standardi për Zdrukthtari është rishikuar dhe përditësuar për të reflektuar kërkesat aktuale të industrisë, teknologjitë e reja dhe praktikat moderne të prodhimit.
- Standardi për Mobileri është zhvilluar për herë të parë, bazuar në kërkesën e Këshillit për Zhvillimin e Fuqisë Punëtore, duke adresuar mungesën e një standardi formal për këtë profesion strategjik.

Procesi përfshiu punë intensive disa mujore, konsultime me kompani anëtare, ekspertë të sektorit dhe akterë relevantë institucionalë. Të dy standardet u finalizuan në janar 2025 dhe u dorëzuan zyrtarisht në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK/NQA), sipas procedurave të përcaktuara ligjore.

Procesi i vlerësimit dhe aprovimit

Në nëntor 2025, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ftoi SHPDK-në për mbrojtjen zyrtare të dy standardeve profesionale para panelit të ekspertëve, ku u prezantua metodologjia e punës, përmbajtja profesionale dhe përputhshmëria me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.
Paneli vlerësues e vlerësoi lart punën e realizuar, duke e konsideruar procesin profesional, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt tregut të punës.

Si rezultat, **të dy standardet u aprovuan nga Këshilli Drejtues i AKK-së në dhjetor 2025**, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt profesionalizimit dhe standardizimit afatgjatë të sektorit të industrisë së drurit. Ky sukses pozicionon SHPDK-në si partner të besueshëm për institucionet publike dhe donatorët ndërkombëtarë.



10. SHPDK – Projekti: Empowering Kosovo's Wood Industry through Dual Vocational Education and Training Innovation
Mbështetur nga: Luxembourg Development Cooperation Agency
Periudha: Tetor 2025 – Shtator 2026

Qëllimi

Ky projekt synon forcimin e arsimit dual në Kosovë përmes ndërmjetësimit të bashkëpunimit midis kompanive të sektorit privat të përpunimit të drurit dhe institucioneve të arsimit profesional (VET). Ai ka për qëllim zhvillimin e një strategjie të integruar komunikimi për promovimin e arsimit dual, formalizimin e marrëveshjeve midis shkollave dhe ofruesve të arsimit profesional me kompanitë, përgatitjen e trajnimeve të bazuara në kompetenca për profilet CNC dhe Eco-Finishing, forcimin institucional të AWPK-së për koordinimin dhe zgjerimin e arsimit dual, si dhe ngritjen e një platforme të qëndrueshme për koordinimin dhe komunikimin e aktiviteteve të arsimit dual.

Realizimi dhe Aktivitetet nga SHPDK deri më tani:

- **Konventa e Industrisë së Drurit të Kosovës – Edicioni i 8-të**
  - Data: 26 Nëntor 2025 | Vendi: Hotel Emerald, Prishtinë
  - Organizuar nga SHPDK – Wood Cluster dhe mbështetur nga LuxDev – Projekti KSV/021, FEGO (SIDA), ProCredit Bank dhe Swisscontact (MSJ).
  - Synimi: Promovimi i sektorit të përpunimit të drurit, ndërgjegjësimi për arsimin dual dhe krijimi i lidhjeve ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare.

- **Kick-off Workshop me partnerët OPA**
  - Data: 11 Dhjetor 2025 | Vendi: Courtyard by Marriott, Prishtinë
  - Qëllimi: Prezantimi i projektit, harmonizimi i aktiviteteve midis SHPDK dhe KCC, organizimi i sesioneve informuese dhe përgatitja e konsorciumeve për skemat e granteve.

- **Workshop-et Informuese nga SHPDK në Rajonet e Kosovës**

SHPDK, në bashkëpunim me **OEK, MIRECK dhe LuxDev**, organizoi workshop-e informuese në rajonet e Prishtinës, Ferizajt dhe Gjilanit, me fokus në **Mësimin Profesional Dual dhe skemat e granteve për kompanitë**:

Rajoni i Prishtinës
Data: 21 Tetor 2025
Vendi: Tech Park – Bërnicë

Rajoni i Ferizajit
Data: 23 Dhjetor 2025
Vendi: USHAF – Ferizaj

Rajoni i Gjilanit
Data: 23 Dhjetor 2025
Vendi: SHMAP “Adem Kastrati” – Gjilan

Qëllimi i Workshopeve:

- Informimi i bizneseve dhe aktorëve relevantë mbi Mësimin Profesional Dual dhe skemat e granteve; diskutimi i rolit të kompanive në arsimin profesional dhe mundësive të bashkëpunimit;
- Prezantimi i përfitimeve të mësimit profesional dual për kompanitë;
- Informimi mbi obligimet ligjore dhe administrative për pranimin e nxënësve në praktikë;
- Prezantimi i skemave të granteve të ofruara nga Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor;
- Ofrimi i hapave konkretë për bashkëpunim me shkollat profesionale dhe përfitim nga programet ekzistuese.

Rezultatet e pritura dhe arritjet e aktivitetit:

- Kompanitë fituan njohuri të qarta për integrimin e nxënësve praktikantë;
- Mundësia për të aplikuar për grante dhe mbështetje financiare;
- Ndërtimi i partneriteteve të qëndrueshme me shkollat profesionale dhe sektorin privat.
- **Mbi 100 përfaqësues** të bizneseve, shkollave profesionale dhe institucioneve relevante morën pjesë në këto aktivitete, duke siguruar diskutime të frytshme dhe ndarjen e praktikave më të mira.


WOOD INDUSTRY
CONVENTION







11. SHPDK – Organizimi i Konventës së Industrisë së Drurit – Edicioni 8
Mbështetur nga: LuxDev – projekti "Shkathtësitë për punësim të qëndrueshëm në Kosovë", Swisscontact - projekti FEGO i financuar nga Qeveria e Suedisë, ProCredit Bank, si dhe projekti "Matching Skills to Job" (MSJ), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe implementuar nga Swisscontact.
Periudha: Tetor – Nëntor 2025

Qëllimi

Edicioni i tetë i Konventës së Industrisë së Drurit të Kosovës ishte ngjarja kryesore kombëtare që theksoi rëndësinë e industrisë së përpunimit të drurit si sektor strategjik për rritjen ekonomike dhe punësimin në vend. Ky edicion pati për qëllim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, inovacionit dhe digjitalizimit në sektorin e drurit, duke fuqizuar industrinë përmes modernizimit, digjitalizimit, zhvillimit të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe zgjerimit të mundësive për eksport.Tema e këtij edicioni ishte "Modernizimi i Industrisë së Drurit përmes Inovacionit, Digjitalizimit dhe Zhvillimit të Kapitalit Njerëzor", me fokus në rritjen e eksporteve, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe promovimin e praktikave të gjelbra dhe të qëndrueshme në prodhim. Konventa shërbeu si një platformë gjithëpërfshirëse bashkëpunimi, duke bashkuar përfaqësues të institucioneve publike, bizneseve, organizatave ndërkombëtare dhe botës akademike për të diskutuar trendet, sfidat dhe mundësitë që formësuan industrinë e drurit në epokën digjitale.

Aktiviteti dhe pjesëmarrja

- Organizimi dhe koordinimi i **logjistikës së Konventës**, përfshirë zgjedhjen e vendit të ngjarjes, hartimin e agjendës, zgjedhjen e folësve dhe ekspozuesve, si dhe organizimin e sesioneve të paneleve dhe takimeve Business-to-Business (B2B).
- Organizimi i ekspozitës së produkteve të drurit të prodhuara në Kosovë, për të promovuar mjeshtërinë vendore, cilësinë dhe potencialin eksportues.
- Organizimi dhe koordinimi i **Garës Studentore për Dizajn**, me pjesëmarrjen e studentëve nga UBT, USHAF, AAB dhe UP Fakulteti i Arkitekturës.
- Sigurimi i **kontaktit të vazhdueshëm me koordinatorët e universiteteve**, për të garantuar pjesëmarrjen dhe përgatitjen e studentëve.
- Organizimi i **Takimeve Business-to-Business (B2B)** për të nxitur shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunime midis kompanive vendore dhe ndërkombëtare.
- Organizimi i **paneleve tematike**, me pjesëmarrjen e ekspertëve nga industria, institucionet dhe organizatat partnere, për të diskutuar trendet, sfidat dhe mundësitë në sektorin e drurit.
- Sigurimi i **shtandeve të kompanive të digjitalizimit dhe softuerëve industrialë**, që ofruan zgjidhje për automatizim, optimizim të proceseve dhe rritje të efikasitetit prodhues.
- Organizimi i **ekspozimit të punimeve të finalistëve të Garës Studentore për Dizajn**, ku studentët morën certifikata pjesëmarrjeje dhe shpërblime për tre vendet e para.

Rezultate

- Grumbulloi mbi **300** pjesëmarrës, duke përfshirë kompani vendore, ndërkombëtare, institucione dhe akademikë.
- Ofroi platformë gjithëpërfshirëse për diskutime, panele dhe forume interaktive mbi sfidat, trendet dhe mundësitë në sektor.
- Prezentoi ekspozita të produkteve vendore dhe ndërkombëtare, teknologji moderne dhe zgjidhje digjitale për automatizim dhe optimizim të proceseve prodhuese (**25** kompani ekspozuan).
- Organizuar takime Business-to-Business (B2B), duke mundësuar ndërveprime direkte dhe mundësi për tregjet e jashtme.
- Realizuar gara studentore për dizajn, duke promovuar kreativitetin dhe lidhjen mes arsimit dhe industrisë.
- Pjesëmarrja ndërkombëtare: Pjesëmarrja në nivel të lartë nga figura qeveritare dhe
- ndërkombëtare, përfshirë Kryeministrin e Kosovës, forcoi rëndësinë e ngjarjes.
- Rritur ndërgjegjësimin për potencialin e industrisë së drurit, me mbulim të gjerë në media televizive, radio, shtyp dhe online.
- Pjesëmarrësit dhe publiku vlerësuan cilësinë e diskutimeve, organizimin dhe mundësitë e rrjetëzimit, duke konfirmuar suksesin e Konventës.










KONVENTA E
INDUSTRISË
8
EDICIONI I
SHPDK

PREZENCA NE MEDIA DHE RRJETE SOCIALE

Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK) është **e pranishme në mënyrë të vazhdueshme në media dhe rrjetet sociale**, duke siguruar që çdo informacion mbi aktivitetet, projektet dhe mundësitë për kompanitë anëtare të jetë i qasshëm për publikun dhe partnerët.

SHPDK **promovon vazhdimisht anëtarët e saj**, duke i dhënë zë kompanive përmes postimeve në Facebook, njoftimeve në webfaqe dhe prezencës në media të ndryshme.

Kjo përfshin:

- Prezantimin e aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të kompanive anëtare;
- Njoftime për pjesëmarrjen në panaire, workshop-e dhe ngjarje ndërkombëtare;
- Mundësi për bashkëpunim dhe lidhje me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë.

Që nga fillimi i vitit 2025, SHPDK ka shënuar një përparim të dukshëm në rritjen e pranisë së saj në mediat sociale si pjesë e përpjekjeve të saj në fushën e marketingut. SHPDK ka përjetuar një rritje të fortë në faqen e saj në Facebook, duke shtuar numrin e ndjekësve dhe duke arritur një audiencë të gjerë. Po ashtu, raportimet e mediave për ngjarjet në të cilat ka marrë pjesë SHPDK kanë qenë të gjera duke e promovuar në këtë mënyrë industrinë.

Me këtë prezencë, SHPDK synon:

- Të mbajë bizneset dhe profesionistët të informuar mbi zhvillimet e fundit në industrinë e drurit;
- Të promovojë aktivitetet, anëtarët, standardet dhe iniciativat e arsimit profesional dual;
- Të ofrojë një platformë për komunikim dhe ndarje eksperiencash ndërmjet anëtarëve dhe partnerëve.

https://www.youtube.com/watch?v=-u1VkO-EeP0

https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=tIPPGlsxnQY&fbclid=IwY2xjawIYGLNleHRuA2FlbQIxMQABHQStFiCEMZlDx86K_eUXx7q49LHoZFX5BqzLZtTS3BV2zq9MRypIe0xg9A_aem_YNOa7OSNB25kLWpJH2ppSQ

https://www.facebook.com/reel/1337353110905159

https://www.albinfo.ch/stockholm-fitore-syla-po-prezanton-dy-produkte-inovative-leka-lighting-dhe-mirror/?fbclid=IwY2xjawIYGXJleHRuA2FlbQIxMQABHdslH77Pzo3ZQ1BQ8GhvyRdcKv3ZY8Glpt3SIIMsye8yRsrSQNu3DPexfw_aem_clmbsYaQE8Lqr6XJoDkpzg

https://www.facebook.com/photo/?fbid=629321656432959&set=a.167639062601223

https://www.youtube.com/watch?v=iIVuIPZxhDM

youtube.com/watch?si=Gq2qdoUHxBaJ-BkB&fbclid=IwY2xjawOjAohleHRuA2FlbQIxMQBzcnRjBmFwcF9pZBAyMjIwMzkxNzg4MjAwODkyAAEeK1YHYiV4JsgAGe97bH3Yj-JMUnG_6h9VuaNonglOEEnUNP9cMw_tcGurRqE_aem_Zqv2oYIV47DFk1YXiSd1qQ&v=kP_gpBB3sQQ&feature=youtu.be

https://kosovanews.net/kurti-mori-pjese-ne-edicionin-e-8-te-te-konventes-se-industrise-se-drurit/

https://www.youtube.com/watch?v=21ESrfES2XM

https://mint.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,3,1799

https://kosova.info/kurti-ne-konventen-e-drurit-2025-kosova-synon-te-behet-qender-rajonale-e-prodhimit-te-mobilieve/

https://buletiniekonomik.com/2025/11/konventa-e-industrise-se-drurit-shenon-edicionin-e-tete/

https://aab-edu.net/konventa-8-perpunimit-dru-kolegji-aab-bashkepunimi-akademi-industri/

https://www.facebook.com/photo/?fbid=818447050799714&set=a.139099922067767

youtube.com/watch?si=tDSge3w1JnegUpzy&fbclid=IwY2xjawOikjVleHRuA2FlbQIxMQBzcnRjBmFwcF9pZBAyMjIwMzkxNzg4MjAwODkyAAEeOvwnveDudHzAgQaqzjzElaWuPxSYDtjQyfQlFG9Ls8M3cRrlB_fyKgrqktE_aem_d4R13vSWrHoxw98SfkMurQ&v=RSqYfL9nlTQ&feature=youtu.be

https://www.facebook.com/photo?fbid=833442292765614&set=pcb.833443712765472

https://www.albinfo.at/kurti-dhe-hajdari-vizitojne-konventen-e-drurit-2025-fokus-ne-inovacion-dhe-eksport/?fbclid=IwY2xjawOikwxleHRuA2FlbQIxMQBzcnRjBmFwcF9pZBAyMjIwMzkxNzg4MjAwODkyAAEeR3kcwnXZdFcvsdgJ06vLoNW2XwOUOKk1YbD18DOCbOMmokd7CUW1lJpyo2Q_aem_EgigVy8bSnGWMUc3th2byA

https://www.facebook.com/photo/?fbid=1256345339857855&set=a.628279725997756

REZULTATET DHE TË ARRITURAT E SHPDK-së gjatë periudhes Janar – Dhjetor 2025

Falenderojmë donatorët dhe institucionet tona për përkrahjen e fuqishme gjatë gjithë kësaj kohe, pa te cilët nuk do te ishte i mundur realizimi i këtyre aktiviteteve dhe arritja e këtyre rezultateve:

- **IREX- Private Sector-Led Workforce Development.**
- **Swisscontact - FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA).**
- **LuxDev, the Luxembourg Development Cooperation Agency - Skills for Sustainable Jobs in Kosovo.**
- **Swisscontact - "Matching Skills to Job" (MSJ), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).**
- **ProCredit Bank**

EKSPOZIME

- Rreth 50 kompani morën pjesë në ekspozim
- Mbi 300 takime B2B
- Mbi 100 kompani në vizita në panaire ndërkombëtare (Gjermani, Turqi, Suedi)

REZULTATI I EKSPORTIT NGA EKSPOZIMET 2025

- **5,000.000.00 Euro**

PROMOVIM

- Promovim i Anëtarëve në Media Sociale në vazhdimësi
- Mbi 300 pjesmarrës në Konventë
- Mbi 100 pjesëmarrës në Workshope
- Platforma e SHPDK dhe E-commerce https://kosovowood.org/
- Katalogu i industrisë së Drurit https://kosovowood.org/Uploads/Page/Document/20/awpk_final_ALB.pdf
- Harta e Industrisë së Drurit https://kosovowood.org/Harta-Interaktive
- Analiza/Statistikat e Industrisë së Drurit https://www.workforcedata-ks.org/wooddashboard

ANËTARËT E SHPDK-së

https://kosovowood.org/Anetaret